



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PERGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.181/6 prot.

Tiranë më 24.3.2023

REKOMANDIM

Nr. 19, datë 24.3.2023

PËR KONTROLLUESIN “ALEAT SH.P.K”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “ALEAT SH.P.K” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 10, datë 18.01.2023, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi “Aleat Shpk”.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një kompani që operon në Shqipëri në bazë të një kontrate konçesioni të lidhur me qeverinë shqiptare ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë dhe konsorciumit të IDEMIA SA (Francë), si dhe Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve (Shqipëri) për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe Pasaportave biometrike për qytetarët shqiptarë.

Në zbatim të kontratës koncensionare, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave shtetas shqiptarë, shtetas të huaj që jetojnë në Shqipëri, diplomatë dhe zyrtarë të lartë, etj., me qëllim prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve të identitetit ku përfshihen pasaporta dhe karta identiteti.

Gjithashtu, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave, “punonjës”, “vizitorë”, “kandidatë për punë”, “klientë”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Gjatë ushtrimit të aktivitetit me qëllim ofrimin e shërbimit të prodhimit, shpërndarjes dhe identifikimit të Letërnjoftimeve ID, Kontrolluesi përdor sisteme elektronik dhe platforma teknologjike të tilla si:

- MEVA;
- MCIVIS / MBSS;
- MCS;
- MPerso;
- IDCA;
- eTIS .

Sistemi elektronik MEVA është sistemi kryesor i aktivitetit të Aleat, proceset që kryen ky sistem janë:

- Regjistrimi i subjekteve të të dhënave për aplikim për dokumente identiteti (kartë identiteti dhe pasaportë).
- Shpërndarja e dokumenteve të identitetit (letërnjoftim dhe pasaportë):
- Shërbimet pas lëshimit.

Proceset kryesore që kryen sistemi elektronik MCIVIS, janë:

- Ngarkimi i të dhënave;
- Marrja elektronike i të dhënave;
- Arkivimi.
- Ndërveprimi

Gjithashtu, një ndër sistemet kryesore që përdor Aleat është sistemi eTIS i cili ofron shërbime online për palët e treta, konkretisht:

- Vërtetim për identifikimin e mbajtësit të kartës ID;
- Mundësinë për të nënshkruar në mënyrë dixhitale një dokument për çdo mbajtës të kartës;
- Mundësinë për të ofruar informacion për mbajtësin e kartës;
- Mundësinë për të vërtetuar përshtatshmërinë për një shërbim të një mbajtësi të kartës.

Platforma eALEAT si pjesë përbërëse e sistemit eTIS ofron për palët e treta tre shërbime kryesore nëpërmjet lexuesit të Kartës, si :

- Autentifikim;
- Autentifikim dhe të dhëna;
- Nënshkrim Elektronik.

Shërbimet online për palët e treta të sipërcituara, Aleat i kryen mbështetur në parashikimet e shtojcës nr. 4, të Kontratës Koncesionare me qeverinë shqiptare lidhur më datë 21.07.2008 dhe amenduar me kontratën e datës 10.03.2013 “Për zgjatjen dhe përmirësimin e kontratës së koncesionit për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pasaportave elektronike”, ratifikuar me ligjin nr. 129/2013 “Për ratifikimin e kontratës për zgjatjen dhe përmirësimin e kontratës së Koncesionit...”.

3. Kontrolluesi disponon një sistem video survejimi (CCTV), i përbërë nga 53 kamera të cilat survejojnë korridoret, ambientet e brendshme të zyrave dhe ambientet e jashtme të Kontrolluesit. Konstatohet se kamerat janë pozicionuar në ambientet e brendshme të zyrave, në kundërshtim me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video/audio-survejit (CCTV). Të dhënat e ruajtura në këto sisteme si “imazhe”, “video” dhe “zëri/audio”, janë të dhëna personale, dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesit.

4. Kontrolluesi ka marrëdhënie kontraktuale me palët e treta për ofrimin e shërbimeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij. Konkretisht, Kontrolluesi ka lidhur më datë 01.12.2021, me subjektin “Hoxha SHPK”, Marrëveshje “Security system maintenance agreement”, me qëllim delegimin e shërbimit të mbikëqyrjes me sistemin CCTV të ambienteve të Kontrolluesit, si dhe të access controller-it.

Nga shqyrtimi i kësaj Marrëveshje rezulton se, në përmbajtje të saj nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale dhe/ose një shërbimi, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të

garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Detyrimet e përpunuesit për përpunimin e të dhënave personale, parashikohen në nenin 20 të Ligjit dhe rregullohen me aplikimin e Udhëzimit nr. 19.

Detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e shkruar mes Kontrolluesit dhe ofruesit të shërbimit, në cilësinë e Përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi (*outsourcing*) që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbaj dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikoj masat që duhet të marr përpunuesi për të siguruar/garantuar mbrojtjen e të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancën dëgjimore, ku parashitroi se qëndrimin mbi konstatimet e grupit të hetimit do ti paraqesë me shkrim.

Me shkresën nr. 23-0197 prot., datë 03.03.2023, Kontrolluesi parashitroi argumentet mbi konstatimet.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuadër të garantimit të të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe garantimit të ligjshmërisë së përpunimit. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 6, 20, 29, 30, 31 (pika 1, germa "a/l"), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDUJ:

1. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit, dhe Udhëzimit nr. 11 të Komisionerit, të bëjë një rivlerësim, në lidhje me vendosjen e kamerave dhe ambientet

që do të mbikëqyren, në përputhje me qëllimin e përpunimit, duke vlerësuar ato raste në të cilat monitorimi përmes sistemit të kamerave tejkalon qëllimin;

2. Kontrolluesi, të marrë masa për të përfshirë në kontratën me përpunuesin, detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
3. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përpunimin e të dhënave personale në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
4. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 2 më sipër;
 - (ii) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 3.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;
6. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 24.3.2023.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi